


# Ndërkombëtarizimi i UP-së

But Dedaj, drejtor i Zyrës së WUS Austria në Kosovë, ka thënë se projekt, përfitues i të cilit është Universiteti i Prishtinës, përveçse ka rëndësi në ngritjen e kapaciteteve vendore dhe reformën në kurrikulë, ka rëndësi të madhe edhe në ndërkombëtarizimin e Universitetit të Prishtinës

PRISHTINË, 17 JANAR

Doktoratura në "Shkenca të ushqimit dhe teknologji të ushqimit", si dhe krijimi i kapaciteteve për reformë të studimeve të doktoraturës në Universitetin e Prishtinës (UP), është ky projekti më i ri i programit TEMPUS. Përkitazi me këtë çështje të hënën është zhvilluar takimi nismëtar për këtë projekt, qëllimi i të cilit është ta mbështesë reformën në kurrikulë (planprogram) të programeve të doktoratës (PhD) dhe ngritjen e kapaciteteve në Universitetin e Prishtinës, në përputhshmëri me procesin e Bolonjës dhe me zhvillimet e fundit evropiane, me qëllim që të mbështetet integrimi i Kosovës në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë.

Me këtë rast But Dedaj, drejtor i Zyrës së WUS Austria në Kosovë, ka thënë se projekt, përfitues i të cilit është Universiteti i Prishtinës, përveçse ka rëndësi në ngritjen e kapaciteteve vendore dhe reformën në kurrikulë, ka rëndësi të madhe edhe në



But Dedaj

ndërkombëtarizimin e Universitetit të Prishtinës. Ndërsa Mujë Rugova, rektor i Universitetit të Prishtinës, ka thënë se fillimi i këtij programi të doktoratës do të kontribuojë në arsimimin dhe përgatitjen e

ekspertëve të rinj në fushën e teknologjisë së ushqimit. "Përveç kësaj, qëllimi është të krijohet një praktikë model në Universitetin e Prishtinës, ku ofrohen programe të doktoratës, të cilat bazohen në

standardet më të larta evropiane, në kurrikulë bashkëkohore e në trend me zhvillimet e fundit në shkencë, hulumtim shkencor, mobilitet të studenteve, ndërkombëtarizim dhe sigurim të cilësisë", ka thënë

Rugova.

Ndërkaq, Avdulla Aliaj, drejtor i Zyrës për Arsim të Lartë në MASHT, është shprehur me këtë rast se ministria e Arsimit, veçmas UP po bëjnë punë të madhe në procesin e konsolidimit të mekanizmave për të siguruar një arsim të lartë cilësor, të krahasueshëm dhe konkurrent në Hapësirën Evropiane të Arsimit të Lartë. Kontraktues i këtij projekti është Universiteti i Grazit, kurse koordinatorë është WUS Austria, ndërsa përfitues direkt i projektit është Universiteti i Prishtinës. Përveç këtyre, partnerët e tjerë të projektit janë edhe: Universiteti Teknik i Munihut (Gjermani), Universiteti i Granadas (Spanjë), Universiteti Vassa (Finlandë), Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Kosovës, Agjencja Kosovare e Akreditimit, Shërbimi Austriak i Studentëve, Unioni i Pavarur i Studentëve i UP-së dhe Lista Studentore Reforma. Projekti në fjalë financohet nga Programi TEMPUS i Komisionit Evropian.